

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Tabaku: Shqipëria nuk vuan nga "republika e prokurorëve", por nga republika e të korruptuarve
ADRESA	https://lapsi.al/tabaku-shqiperia-nuk-vuan-nga-republika-e-prokuroreve-por-nga-republika-e-te-korruptuarve-i1094636
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA

KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 12:25:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 12:23:57 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	347a5b1aef23e6f714ac7b1a4dbeeaa30ccc5b5c14463016524b7c6df1bc16fd
TEKSTI	898d38ac9fdddc21770cbfa8718683373ad82fb680d63e8f4631af4d0cad4bc4
PAMJA	2fc225755f119dfd26c52c7517bed0043ed61a4c4cb940bb126ff53f305dfef1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2aba1f642838ca743f01a876d06cd6f6b61974ff95243e51a8f84980f9c05cbe
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	37c1183d944b9abe724532469e5e873d69da6740426bb5bc7e8618c3c9fa36bf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2aba1f642838ca743f01a876d06cd6f6b61974ff95243e51a8f84980f9c05cbe>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Tabaku: Shqipëria nuk vuan nga "republika e prokurorëve", por nga republika e të korruptuarve

Deputetja e Partisë Demokratike kërkon përgjegjësi politike për korrupsionin, transparencë për PPP-të dhe prokurimet, si dhe institucione që nuk veprojnë jashtë kontrollit ligjor.



LAPSI.AL • 28 SEPTEMBER 2026



Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku, nënkryetare e Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri dhe bashkëkryetare e Komisionit për Çështjet Europiane, deklaroi se integrimi evropian nuk mund të kufizohet te hapja e kapitujve, por duhet të sjellë ndryshim të mënyrës së qeverisjes, forcim të institucioneve dhe fundin e pandëshkueshmërisë.

Gjatë fjalës së mbajtur në Tiranë, në konferencën e komisioneve parlamentare për çështjet europiane dhe punët e jashtme të vendeve të Bashkimit Europian, Tabaku theksoi se hetimet ndaj zyrtarëve të lartë tregojnë se organet e drejtësisë po veprojnë, por nuk mund të përdoren si dëshmi e pastërtisë së qeverisë.

"Hetimi i zyrtarëve të lartë tregon se drejtësia po vepron. Por kjo nuk është certifikatë pastërtie për qeverinë. Kjo tregon sistemin e korruptuar që është ngritur", u shpreh ajo.

Sipas Tabakut, përgjegjësia penale është individuale, ndërsa përgjegjësia politike u përket atyre që emërojnë, mbikëqyrin dhe kontrollojnë administratën. Ajo nënvizoi se rruga drejt Bashkimit Europian kërkon përgjegjësi politike dhe jo avokati politike për personat nën hetim apo të akuzuar për korrupsion.

Deputetja demokrate kritikoi përpjekjet për të sulmuar prokurorët apo për ta paraqitur hetimin si persekutim politik, duke përdorur si alibi prezumimin e pafajësisë dhe të drejtat e njeriut.

ide



Një histori korruptimi jo dashurimi
Blendi Kajsia



Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm
Andi Bushati

MOTITIRANA

25°C

KËMBIMIEURO

91.97

aktuale

15:00

Rama lan duart me skandalin e SHISH: Çështje individuale e Vlora Hysenit me drejtësisë



Rama nis sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit

22:06



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndique Lapsin edhe në



Me interes nga publiku

"Prezumimi i pafajësisë nuk mund të përdoret për të ndërtuar prezumimin e fajësisë ndaj prokurorëve. Shqipëria nuk vuan nga një 'republikë prokurorësh'. Ajo vuan nga një republikë e të korruptuarve që kanë grumbulluar aq shumë pushtet, pasuri dhe arrogancë, sa besojnë se ligji është vetëm për të tjerët dhe se drejtësia duhet të ndalet te dera e tyre", deklaroi Tabaku.

Ajo shtoi se mbështetja për drejtësinë nuk mund të jetë selektive, duke e përsëritur atë kur godet kundërshtarin dhe duke e sulmuar sapo hetimet i afrohen pushtetit.

Në fjalën e saj, Tabaku ngriti shqetësimin edhe për agjencitë, kompanitë shtetërore dhe strukturat që veprojnë në sektorë strategjikë, duke i referuar edhe debatit mbi raste si KAYO. Sipas saj, asnjë strukturë nuk mund të vendoset jashtë kontrollit ligjor, parlamentar dhe kushtetues.

"Mbrotjtja, siguria, shëndetësia, infrastruktura dhe digjitalizimi nuk mund të kthehen në zona të përjashtuara nga transparencja, konkurrenca dhe kontrolli parlamentar. Rëndësia strategjike e një sektori nuk mund të përdoret si alibi për kontrata jotransparente, përqendrim kompetencash apo partneritete të pakontrolluara", tha ajo.

Tabaku paraqiti edhe angazhimet që, sipas saj, duhet të shoqërojnë procesin e integritetit: moslejimin e përdorimit të imunitetit parlamentar si mburojë ndaj drejtësisë, emërime mbi bazën e meritës, kontroll real parlamentar dhe transparencë të plotë për prokurimet publike, koncesionet, PPP-të, investimet strategjike dhe fondet europiane.

Ajo kërkoi gjithashtu një ekonomi konkurruese dhe të ndershme, e cila lufton informalitetin dhe paranë e pistë, në vend të një sistemi ku kontratat publike ndahen me paracaktim dhe konkurrenca pengohet.

"Shqipëria nuk duhet të hyjë në Europë duke i fshehur problemet e saj. Duhet të hyjë duke i zgjidhur ato. Jo nga dritarja e propagandës, por nga dera e reformave, përgjegjësisë dhe sundimit të ligjit", u shpreh Tabaku.

Në përfundim, deputetja demokrate theksoi se Europa nuk është vetëm një destinacion gjeografik, por modeli i qeverisjes dhe i shtetit që meritojnë shqiptarët.

"Ne e duam Europën të plotë, jo me pjesë. Duam ligjet europiane, standardet europiane, frymën dhe thelbin e saj. Duam të bëhemi pjesë e familjes europiane me meritë dhe kërkojmë ndihmën tuaj për ta realizuar këtë", përfundoi Tabaku.



Rama sulmon dy televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokurori



Pse nuk bind alibia e kryeministrit "leshko", që nuk e dinte për Vlora Hysenin dhe Ergys Agasin



WSJ: Si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 miliardë \$ në Shqipëri



Një histori korruptimi jo dashurimi

Të këshilluara



Aksidentet rrugore rriten me 6.2% në tetë muaj, më të rrezikshmet Tirana dhe Durrësi

Aksidentet rrugore u rritën me 6.2% në tetë muajt e parë të vitit 2026, të nxitura kryesisht nga një shtim i fortë i ra...



Deklaratë unanime për UÇK-në/ Kuvendi i Kosovës kundërshton Hagën

Kuvendi i ri i Kosovës ka miratuar të hënën, në seancën e tij të parë plenare, një deklaratë lidhur me aktgjy...





Vodhën 6 makina në Kavajë, Durrës dhe Tiranë, në pranga 2 autorët



Autorët u paraqitën si Taulant Balla: Si u tentua zhvatja e Armand Dukës për 100 mijë euro

Dy të rinj janë arrestuar në kuadër të një operacioni të zhvilluar në Tiranë, pas dyshimeve se kanë tentuar t...



Burimas/ Sherr mes banorëve dhe policisë për ujin e pijshëm, kolapsohet një qytetar

Protesta e tretë e banorëve të Burimasit kundër projektit për furnizimin me ujë të Zvezdës është shoqëru...



PDK-ja e gatshme të diskutojë për presidentin, nëse kalon projektligji për Specialen

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka thënë se nëse miratohet projektligji për ndryshimin dhe plo...




Digjet grumbulli i mbetjeve në Lezhë, flakët rrezikuan disa banesa



"Armand Duka jam"/ Tentuan t'i zhvasnin 100 mijë euro një 64-vjeçari

Dy të rinj janë vënë në pranga nga Policia e Tiranës, pasi përmes mashtrimit në rrjetet sociale, tentuan të zhvasn...



Ambasadorja e BE-së: Shqipëria të çojë deri në fund reformat e nisura

Ambasadorja e BE-së në Shqipëri Sofia Moreira se la Sousa, në fjalën e saj në Konferencën Ndërqeveritare tha se zgjerim...



Këshilli Bashkiak i Maliqit kundër bashkimit me Korçën, 21 anëtarë votojnë kundër, vetëm 1 pro

Këshilli Bashkiak i Maliqit ka kundërshtuar propozimin për bashkimin e kësaj bashkie me Bashkinë e Korçës, në kuadër...

Me sytë katër



19:19

VIDEO/ Qëllohet me vezë kryeministri hungarez Péter Magyar

Një incident ka ndërprerë fjalimin e kryeministrit hungarez Péter Magyar gjatë një aktiviteti elektorale në qytetin e Szoln...



VIDEO/ Theu derën e supermarketit në Vlorë dhe mori kasën, por u arrestua

17:23



"Më shau, e shava"/ Shefi i komisariatit të Krujës flet pas pamjeve të shpullës

21:35



PAMJET/ Protestuesit kapin Bledi Çuçin në kafe, bashkëshortja e tij Delina Fico humb durimin

23:13



VIDEO/ Muriqi feston me bluzën e UÇK-së golin ndaj Irlandës

22:44

SPORT

→ Të tjerë artikuj



13:59

Aedan Scipio, futbollisti me flokët e lidhur në bel: dy lojtarë u përjashtuan se i tërhoqën gërshetat



13:31

Maran humb Caken për San Marinos, dërgon në shtëpi Simonin: Kombëtarja heq dorë nga stërvija zyrtare



13:08

Irlanda mposhti Izraelin brenda e jashtë fushës në ndeshjen e polemikave: koka ulur gjatë himnit, festim për Gazën





PAPARAZZI



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.